

Në bazë të nenit 43 paragrafit (2) pika 12, ndërsa në bazë të nenit 99 paragrafit 3 të Ligjit për Arsimin e Lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës SË Maqedonisë së Veriut " nr. 178/21) Këshilli Kombëtar i Arsimit të Lartë dhe Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore ", në seancën e mbajtur më 11.11.2021 solli

RREGULLORE PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E RAPORTIT TË PUNËS SË REKTORIT

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet përmbajtja dhe forma e raportit për punën e rektorit, i cili dorëzohet konform nenit 99 paragrafit (1) të Ligjit për Arsimin e Lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" " nr. 178/21).

Neni 2

Faqja kryesore, me paraqitje si në Shtojcën 1, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, përmban:

- Logon e Universitetit
- Emrin e Universitetit
- Periudhën të cilës i referohet raporti
- Titullin mësimor- shkencor dhe emrin dhe mbiemrin e rektorit
- Vendin dhe
- Datën e parashtrimit

Neni 3

Raporti i punës së rektorit përmban dy lloje elementesh:

- Të detyrueshme dhe
- Opcionale

Neni 4

Elementet e detyrueshme duhet të ndiqen sipas radhës së dhënë në shtojcën 1, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Nëse nuk është ndërmarrë asnjë veprim për asnjë nga elementet e detyrueshëm gjatë periudhës raportuese, kjo shenohet ndërsa në përmbajtje jepet arsyetim i shkurtër se gjatë periudhës raportuese nuk janë ndërmarrë aktivitete.

Neni 5

Elemente të detyrueshme janë:

1. Hyrja
2. Rregullimi normativo-ligjor i veprimtarisë së Universitetit
3. Veprimtaria mësimore-arsimore

4. Veprimtaria kërkimore-shkencore
5. Veprimtaria botuese
6. Bashkëpunimi ndërkombëtar
7. Raportet financiare për aktivitetet e realizuara
8. Veprimtaria në fushën e aplikimit të teknologjive informatike
9. Qendra e karrierës
10. Bashkëpunimi me sektorët ekonomik dhe jo-ekonomik
11. Solemnitetet dhe ngjarjet e tjera

Përshkrim i shkurtër i përmbajtjes të secilit elementë të detyrueshëm është shënuar në Shtojcën 1, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Elementet opsionale të raportit mund të jenë pjesë e raportit në varësi të aktiviteteve të ndërmarrë gjatë periudhës raportuese dhe aty mund të përfshihen:

1. Vlerësimi i jashtëm i universitetit
2. Aktivitetet e njësive të brendshme organizative të Universitetit – fondacione, donacione etj.
3. Aktivitetet nga fusha e sportit, kulturës, artit etj.
(duke përfshirë aktivitetet e organizatave universitare)
4. Të tjera

Në kuadër të elementeve opsionale të raportit, rektori mund të fusë elementë të tjerë, specifike për periudhën së cilës i referohet raporti.

Neni 7

Raporti përgatitet në mënyrë kompjuterike tekst i përpunuar në formatin A4 me madhësinë e shkronjave 12 dhe hapësirë 0,8 me margjina *Normal*, (Top 1 cm, Bottom 1 cm, Left 1 cm, Right 1cm).

Neni 8

Vëllimi i raportit përcaktohet varësisht numrit të përgjithshëm të njësive në përbërje dhe anëtarët e asociuar në përputhje me Statutin e Universitetit.

Vëllimi i raportit në faqe përcaktohet në mënyrën në vazhdim:

- Universiteti në 5 njësi në përbërje dhe anëtarë të asociuar, raport më së shumti 30 faqe.
- Universiteti me 6 -15 njësi në përbërje dhe anëtarë të asociuar, raport më së shumti 90 faqe.
- Universiteti me 16 -30 njësi në përbërje dhe anëtarë të asociuar, raport më së shumti 180 faqe.
- Universitetet me më shumë se 30 njësi përbërëse dhe anëtarë të asociuar raport më së shumti 210 faqe.

Neni 9

Raporti dorëzohet në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën në të cilën zhvillohet mësimi në universitet.

Neni 10


Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

Shkup, 11.11.2021

**KËSHILLI KOMBËTAR PËR ARSIM
TË LARTË DHE VEPRIMTARI KËRKIMORE - SHKENCORE
Prof. Dr. Todor Serafimovski**

Shtojca 1

Formulari i faqes kryesore dhe faqet e tjera të Raportit për punën e Rektorit



(Emri i Universitetit)

**RAPORT I REKTORIT
PËR PUNËN E UNIVERSITETIT**

(Emri i Universitetit)

PËR PERIUDHËN

(Shënohet periudha e raportimit)

(Shënohet titulli mësimoro-shkencor, emri dhe mbiemri i rektorit)

(Vendi dhe data e parashtrimit)

PËRMBAJTJA:

I. ELEMENTET E DETYRUESHME

1. HYRJE

[Vërejtje hyrëse për periudhën të cilës i referohet raporti]

2. RREGULLIMI NORMATIVO - JURIDIK I AKTIVITETIT TË UNIVERSITETIT

[Vështrimi në punën dhe aktet e përgjithshme të sjellura dhe vendimet e: Senatit të Universitetit, Administratës së Rektorit, Këshillit të Universitetit, Situatat dhe çështjet kadrovike, Buletini Universitar, çështjet pronësore dhe juridike dhe aspekte të tjera të kësaj fushe karakteristike për periudhën raportuese]

3. VEPRIMTARIA MËSIMORE – ARSIMORE

[Regjistrimet në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve, miratimi i programeve të reja mësimore /të ndryshuara/plotësuara për ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve dhe aspekte të tjera të kësaj fushe karakteristike për periudhën raportuese]

4. VEPRIMTARIA KËRKIMORE- SHKENCORE

[Të dhënat për projektet kërkimore-shkencore brenda dhe jashtë vendit; Pjesëmarrja në projekte kërkimore shkencore; konferenca të mbajtura; infrastruktura e kërkimit shkencor (laboratorë të kërkimit shkencor dhe laboratorë të akredituar, etj. nëse ka të tillë në periudhën raportuese), numri i punimeve të publikuara në botime shkencore referente dhe aspekte të tjera të kësaj fushe karakteristike për periudhën raportuese]

5. VEPRIMTARIA BOTUESE

[Botimi i teksteve universitare dhe mjeteve mësimore; Botimi i revistave shkencore me bord redaktues; Publikimi i revistave shkencore profesionale; Publikimi i revistave elektronike; Konkurse të realizuara për financimin e veprimtarisë botuese dhe aspekte të tjera të kësaj fushe karakteristike për periudhën raportuese]

6. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

[Pjesëmarrja në programe, rrjete etj. për mobilitetin e studentëve dhe kuadrit mësimor; pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare; anëtarësimet dhe aktivitetet në universitete ndërkombëtare dhe rrjete të tjera; forumet e rektorëve; kryerja e veprimtarisë së arsimit të lartë nga stafi akademik i universitetit në universitetet jashtë vendit; mësimdhënës vizitorë; ngjarje të tjera me karakter ndërkombëtar dhe aspekte të tjera të kësaj fushe karakteristike të periudhës raportuese]

7. RAPORTET FINANCIARE PËR AKTIVITETET E KRYERA

[Të dhënat lidhur me financimin e universitetit dhe aktivitetet e tij dhe aspekte të tjera të kësaj fushe karakteristike të periudhës raportuese]

8. AKTIVITETET NË FUSHEN E APLIKIMIT TE TEKNOLOGJIVE INFORMATIKE

[Aktivitetet në lidhje me ndryshimet në pajisjet e makinerive dhe softuerëve; Aktivitetet në lidhje me infrastrukturën dhe pajisjet e komunikimit dhe avancimin e tyre; Përshkrimi i situatës me shërbimet e bazuara informatike; Aktivitete që lidhen me nevojat e përdoruesve; Prokurimi publik dhe aspekte të tjera të kësaj fushe karakteristike për periudhën raportuese]]

9. QENDRA E KARRIERËS

[Të dhëna për punëtoritë e mbajtura për këshillim në karrierë, organizimi i praktikës për studentë, aktivitete të shoqatave-alumni, ditë të hapura të organizuara dhe aspekte të tjera të kësaj fushe karakteristike për periudhën raportuese]

10. BASHKËPUNIMI ME SEKTORIN EKONOMIK DHE JO-EKONOMIK

[Takimet e realizuara; Memorandume të nënshkruara; Marrëveshje të bursave të studentëve dhe aspekte të tjera të kësaj fushe specifike për periudhën raportuese]

11. SOLEMNITETE DHE NGJARJE TË TJERA

[Të dhëna për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme për universitetin; përvjetore; jubilej; promovimi i doktorëve të shkencave; ndarja e titujve nderi dhe gradave nderi; ndarja e çmimeve, ndarja e llojeve të tjera të mirënjohjeve , soelmenitete të mbajtura dhe aspekte të tjera të kësaj fushe karakteristike për periudhën raportuese]

II. ELEMENTET OPCIONALE

1. VLERËSIMI I JASHTËM I UNIVERSITETIT

2. AKTIVITETET E NJËSIVE TË BRENDSHME ORGANIZATIVE TË UNIVERSITETIT - FONDACIONET, DONACIONET, ETJ.

**3. AKTIVITETET NGA FUSHA E SPORTIT, KULTURËS, ARTIT ETJ. (PERFSHIRE
AKTIVITETET E ORGANIZATAVE UNIVERSITARE)**

[ELEMENTE TË TJERA OPCIONALE]

REKTOR,

(nënshkrim me dorë)